


Përmes vënies në objektiv

Hulumtim mbi ndryshimin e qëndrimeve
ndaj armëve të vogla në Kosovë



VENDI SIGURTË
BEZBEDNOMESTO
SAFE PLACE





Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), është një organizatë joqeveritare e përqëndruar në zbatimin e ligjit që punon për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendim-marrëse, për një rajon ballkanik të drejtë, paqëndashës dhe të zhvilluar.



Saferworld është organizatë joqeveritare e cila punon për parandalimin dhe zvogëlimin e konfliktit të dhunshëm dhe promovimin e qasjeve bashkëpunuese ndaj sigurisë. Ne punojmë me qeveri, organizata ndërkombëtare dhe shoqërinë civile për inkurajimin dhe përkrahjen e politikave dhe praktikave efektive nëpërmes avokimit, hulumtimit dhe zhvillimit të politikave, si dhe nëpërmes përkrahjes së veprimeve të tjerëve.

Mirënjohje

Ky raport u shkrua nga ekipi i projektit VendiSigurtë në Forumin për Iniciativa Qytetare dhe Saferworld. Dëshirojmë që t'i falënderojmë qeveritë e Mbretërisë së Bashkuar dhe Gjermanisë për financimin e këtij hulumtimi përmes përkrahjes së tyre për projektin VendiSigurtë.

Hyrje

Prania e armëve në Kosovë vazhdon të minojë sigurinë e qytetarëve të Kosovës, por në të njëjtën kohë shtron dilemën sesi të zvogëlohet përhapja e armëve pa i dëmtuar më tej ndjenjat shpesh të brishta për sigurinë në mesin e popullatës. Që nga muaji mars 2006, Saferworld dhe Forumi për Iniciativa Qytetare janë duke i përcjellë qëndrimet ndaj armëve në Kosovë dhe lidhjet ndërmjet ndjenjës së sigurisë dhe pranisë së armëve nëpër komunitete. Ky studim trajton ndryshimet në perceptime sa i përket posedimit civil dhe përhapjes së armëve, dhe sugjeron çështjet kyçe që duhet të merren parasysh në hartimin e një kornize për grumbullimin dhe kontrollin e armëve.

Pas shpalljes së pavarësisë nga administrata e Kosovës më 17 Shkurt 2008¹, korniza ligjore për posedimin, përdorimin dhe transferin e armëve është duke ndryshuar. Kuvendi i Kosovës tani është duke shqyrtuar një projektligj për armët që do të duhej të miratohej më vonë gjatë vitit 2008. Shpresojmë se ky ligj do të kontribuojë në zvogëlimin e posedimit të paligjshëm të armëve nga qytetarët e Kosovës dhe do ta rregullojë përdorimin, prodhimin, shitjen, posedimin, eksportin, importin, transitin, transferin përmes ringarkimit dhe ndërmjetësimin e armëve, të pjesëve të tyre dhe të municionit.

Në vitin 2006 është vlerësuar se në Kosovë ekzistojnë rreth 400,000 armë. Prej tyre, 33,936 ishin në posedim të ligjshëm të qytetarëve të veçantë; 45,217 ishin në duart e agjencive zyrtare dhe të kompanive private ndërkombëtare të sigurimit; dhe së paku 317,000 ishin në posedim të paligjshëm të qytetarëve të veçantë dhe të grupeve të tjera². Një pjesë e shpjegimit për

nivelin e lartë të posedimit të paligjshëm të armëve është se ka patur një kornizë të dobët ligjore që rregullonte posedimin e armëve nga civilët. Me kalimin e Ligjit për Armët, kjo kornizë duhet të fuqizohet³.

Ana tjetër e medaljes sa i përket fuqizimit të kornizës për posedim të armëve është hartimi i kornizës për trajtimin e posedimit të paligjshëm, duke shfrytëzuar një kombinim të regjistrimit të ligjshëm të armëve aktualisht në duart e civilëve, nismave për grumbullimin e armëve për të zvogëluar numrin e përgjithshëm të armëve të mbajtura, dhe zvogëlimin e kërkesave për armë përmes përmirësimit të ndjenjave të njerëzve për sigurinë. Ky studim ofron disa sugjerime për mënyrën e të ideuarit të çfarëdo nisme për grumbullimin e armëve, për të siguruar që ato nisma të jenë në pronësi lokale, të përshtatshme në aspektin vendor dhe të ndjeshme sa i përket konfliktit.

Një aspekt tjetër i kontrollit të armëve është ai i kontrollit të transfereve ndërkombëtare të armëve. Pasi që Qeveria e Kosovës tani po hyn në marrëdhënie tregtare me shtetet sovraane sa i përket transferit të armëve, është qenësore që të krijohet një kornizë ligjore në Kosovë, që do të rregullonte këto transfere dhe që do të ishte në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare. Veçanërisht, duke patur parasysh dëshirën (percaktimin) e Kosovës për t'iu bashkuar strukturave Euro-Atlantike, përfshirë këtu Bashkimin Evropian, Kosova duhet të rreshtohet përkrah Kodit të Sjelljes të Bashkimit Evropian për Eksportet e Armëve,⁴ që politikisht i obligon shtetet ndaj një sistemi të bazuar në kritere për vlerësimin e transfereve të armëve.

1 Më 17 Shkurt 2008, Kosova ka shpallur njëanshëm pavarësinë nga Serbia. Në kohën kur po shkruhet ky studim, 51 vende e kanë njohur këtë pavarësi, pjesa më e madhe në bazë të miratimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës nga Kuvendi i Kosovës, që gjendet në: <http://www.unosek.org/unosek/en/statusproposal.html>

2 Anketa mbi Armët e Vogla dhe të Lehta në Kosovë, SEESAC, Saferworld dhe Forumi për Iniciativa Qytetare (2006), gjendet në: <http://www.seesac.org/reports/KOSOVO.pdf>

3 Sipas projekt Ligjit për Armët të Kuvendit të Kosovës, "Armë" konsiderohet secili mjet ose vegël, e punuar me qëllim që nën presionin e gazrave, të cilat shkaktohen gjatë djegies së materialeve shpërthyes, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale të hedhë predha në formë të plumbit, grumbullit prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, që shkakton lëndime të rrezikshme për shëndetin dhe jetën e njerëzve," si dhe "secili mjet tjetër, dedikimi themelor i të cilit është kryerja e sulmit fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve."

4 Gjendet në: <http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/08675r2en8.pdf>

Ky studim bazohet në gjetjet e një ankete të zhvilluar në muajt prill dhe maj 2008, pjesë e një sërë anketash që i përcjellin perceptimet e qytetarëve përkitazi me sigurinë në komunitet, sigurinë dhe drejtësinë, si dhe përhapjen e armëve në Kosovë. Sipas nevojës, anketa mbështetet në të dhënat që janë nxjerrë nga anketat e mëhershme të kësaj serie, të realizuara në mars 2006⁵, dhjetor 2006⁶ dhe në qershor 2007⁷.

Gjetjet kryesore


- Përqindja e të anketuarve që kanë thënë se në komunitetet e tyre ka armë është rritur mes marsit të vitit 2006 dhe prillit/majit 2008 (14.6% e të anketuarve mendojnë se së paku një e katërta e familjeve në komunitetin e tyre kishin armë në prill/maj 2008; 9.3% ishin në vitin 2006).
- Të anketuarit kishin dëgjuar të shtëna armësh më shpesh në prill/maj 2008 se në mars 2006 (62.3% e të anketuarve kishin dëgjuar të shtëna armësh “nga disa herë në vit” krahasuar me 46.0% në vitin 2006).
- Të shtëna armësh janë dëgjuar më shumë nga komuniteti serb: përkundrajt një mesatare prej 7.4%, 13.6 % e të anketuarve serbë të Kosovës i kishin dëgjuar ato “nga disa herë në muaj”.
- 29.2% e të anketuarve do ta siguronin nga një armë po të mundnin, nga 23.6% në mars 2006.
- Shumica e të anketuarve (78.3%) të cilët do ta siguronin një armë do ta bënin një gjë të tillë për të mbrojtur veten dhe familjet e tyre. Shumë më pak prej tyre do ta bënin një gjë të tillë “për të mbrojtur komunitetin tim” në prill/maj 2008 (3.7%) sesa në mars 2006 (21.5%).
- 60.8% e të anketuarve kanë thënë se posedimi i një arme nuk do të bënte që ata ose familjet e tyre të ndiheshin më të sigurt.
- Gjerësisht, sa më i sigurt të ndihet dikush, aq më pak ka të ngjarë të mendojë se posedimi i një arme do të përmirësonte sigurinë e tyre. Prej këtyre të anketuarve, të cilët mendonin se lagjja e tyre ishte “shumë e sigurt” ose “deri diku e sigurt”, 41.5% nuk do ta siguronin një armë po të mundnin, kundrejt 15.2% të cilët do ta bënin një gjë të tillë, gjë që është në masë të konsiderueshme përqindje më e ulët se mesatarja prej 29.2% e të gjithë të anketuarve.
- Sa më mirë e njohin njerëzit njëri-tjetrin, aq më pak ka të ngjarë që ata të pranojnë se ka armë në lagjen e tyre. Të anketuarit të cilët përfshihen në ndërveprime më të afërta sociale, ka më shumë të ngjarë të përgjigjen me “nuk e di” ose refuzojnë të përgjigjen se sa familje në lagje kanë armë. Vetëm 16.5% e të anketuarve të cilët rregullisht “pinë çaj” me fqinjët e tyre thonë se familjet në komunitetin e tyre kanë armë, kundrejt një mesatare prej 27.4%.

5 Anketa mbi Armët e Vogla dhe të Lehta në Kosovë, punimi i cituar.

6 Siguria Njerëzore në Kosovë: Anketa mbi perceptimet (maj 2007), Forumi për Iniciativa Qytetare dhe Saferworld, gjendet në: www.safeplaceproject.org

7 Të dhëna të tjera nga kjo anketë janë analizuar në Policimi në Kosovë: Anketa e perceptimeve mbi policimin (shkurt 2008), Forumi për Iniciativa Qytetare dhe Saferworld, gjendet në: www.safeplaceproject.org

■ **Figura 1:** Perceptimet për armët që mbahen nëpër familje në Kosovë




Përhapja e armëve sot në Kosovë – a po rritet numri apo po rritet vetëdijesimi?

Tregues kryesor i përhapjes së armëve janë vlerësimet e përafërta të të anketuarve për numrin e armëve në komunitetin e tyre. Figura 1 më poshtë, mund të ilustrojë numrin në rritje të armëve nëpër familje, pasi që më shumë të anketuar përgjigjen se ka armë në komunitetin e tyre (14.6% e të anketuarve mendojnë se së paku një e katërta e familjeve në komunitetet e tyre kishin armë në prill/maj 2008, një rritje kjo nga 9.3% sa kishte dy vite më parë) dhe më pak të anketuar përgjigjen se “asnjë familje” nuk ka armë. Ndonëse, një numër i madh i të anketuarve vazhdojnë të refuzojnë të përgjigjen në këtë pyetje ose thonë se ata nuk e dinë nëse ka armë nëpër familje. Në grupet e fokusit, pjesëmarrësit janë të prirë të mohojnë se ka armë në komunitetin e tyre, por gjatë diskutimit të temave të tjera, duket qartë se armët janë të pranishme. Për shembull, shpesh pjesëmarrësit i përdorin shembujt e të shtënave për të ilustruar krimin në komunitetin e tyre. “Në këtë fshat nuk ka të shtëna,” kishte

thënë një pjesëmarrës në grupin e fokusit nga Çagllavica, “plaçkitjet janë klasike, nuk ka fare përdorim të armëve të zjarrit gjatë plaçkitjeve.” Një pjesëmarrës tjetër aty nuk u pajtua: “Ne nuk e dimë këtë. Kjo është arsyeja se pse asnjë nuk mund t’u kundërvihet hajnave – për shkak se njerëzit mendojnë se ata janë të armatosur. Kam dëgjuar se në fshatin [është hequr emri], dikush kishte shtënë në hajna.”

Të dhënat nga marsi 2006 tregojnë se megjithëse 12.8% e të anketuarve theksonin se asnjë familje në komunitetin e tyre nuk mbante armë zjarri, dy-të tretat nuk ishin të gatshëm të përgjigjen në atë pyetje. Deri në prill/maj 2008, numri i të anketuarve që nuk ishin të gatshëm të përgjigjen në këtë pyetje kishte rënë në 61.9%, ndërsa 10.7% kanë thënë se asnjë familje nuk kishte armë zjarri. Kur të merren së bashku, mbase këto statistika sugjerojnë se në vend se përhapja e armëve të shënojë rritje, njerëzit po bëhen më të hapur për të diskutuar rreth pronësisë ndaj armëve në Kosovë, krahasuar me dy vjet më parë. Po ashtu, ata po bëhen më të vetëdijshëm sa i përket përdorimit të armëve në komunitet – gjë që mund të ketë implikime të sigurisë, veçanërisht për grupet që tashmë ndihen të pambrojtur.

■ **Figura 2.** Numri i të shtënave me armë të dëgjura nga të anketuarit gjatë tërë vitit



Duke patur parasysh natyrën e ndjeshme të posedimit të armëve, sidomos kur teknikisht kjo është e paligjshme, parashtrimi i pyetjeve të drejtpërdrejta se a posedon armë një familje priret të mos prodhojë statistika të besueshme. Në vend të kësaj, ekzistojnë disa tregues me të cilët tërthorazi mund të përcillet përhapja e armëve.

62.3% e të anketuarve dëgjojnë të shtëna armësh “disa herë në vit” krahasuar me 46.0% në vitin 2006. Të shtënat me armë janë dëgjuar më shumë nga komuniteti serb: kundrejt një mesatare prej 7.4%, 13.6% të serbëve të Kosovës i dëgjojnë ato “disa herë në muaj”, krahasuar me 6.2% të shqiptarëve të Kosovës dhe 6.5% të pakicave të tjera (në vitin 2006, 6.4% e të anketuarve kishin dëgjuar të shtëna armësh “disa herë në muaj”, pak më ulët se 8.4% e të anketuarve serbë të Kosovës). Prandaj, mund të nënkuptohet se më shumë njerëz kanë dëgjuar më shumë të shtëna në prill/maj 2008 se dy vjet më parë.


Është e mundur që zhurmat që njerëzit u atribuojnë të shtënave me armë në fakt

janë fishekzjarrë ose – mjete shpërthimi fishekzjarrësh, veçanërisht duke patur parasysh festimet që për shumicën në Kosovë lidhen me shpalljen e pavarësisë, pak kohe para se të realizohej kjo anketë. Megjithëse, të dhënat e përkohshme në qershor 2007 tregojnë se 54.4% e të anketuarve kanë dëgjuar të shtëna armësh “disa herë në muaj”, që sugjeron një rritje të vazhdueshme që nga viti 2006.

Ekzistojnë dallime gjeografike. Shumica e të shtënave janë raportuar në Mitrovicë, me 13.0% e të anketuarve që i dëgjonin ato “disa herë në muaj”, pasuar nga Prishtina me 11.0% dhe Peja 6.4%. Po ashtu, kishte një dallim të lehtë ndërmjet zonave urbane (7.0%) dhe atyre rurale (7.9%). Sipas pjesëmarrësve në grupet e fokusit, posedimi i armëve është më i përhapur në zonat rurale dhe ato kufitare, dhe shumë njerëz e konsiderojnë këtë legjitime duke patur parasysh nivelin e perceptimit të pasigurisë në ato lokacione.

Sipas 69.0% e të anketuarve, më së shumti armët në Kosovë përdoren gjatë kremtimeve (mars 2006: 20.2%; dhjetor 2006: 55.5%; qershor

■ **Figura 3:** Raporti ndërmjet të qenit i përgatitur për të siguruar armë dhe numrit të shtënave të dëgjura disa herë në vit



2007: 75.2%), veçanërisht në Gjakovë (ku 86.1% e të anketuarve e dhanë këtë arsye) pasuar nga Peja (80.8%) dhe Prishtina (71.8%). Prandaj, mund të jetë se numri në rritje i të shtënave me armë të dëgjura në prill/maj 2008 është rezultat i të shtënave kremtuese që ndërliken me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. .

Pse njerëzit posedojnë armë?

Aktualisht, 29.2% e të anketuarve do të siguronin armë po të mundnin. Kjo është ngritur nga 23.6% në mars 2006 (shih Figurën 3)⁸. Në prill/maj 2008,

në këto statistika prinin të anketuarit serbë të Kosovës me 33.8%, (pjesëmarrësit e grupit të fokusit në pjesën veriore të Mitrovicës thanë se “çdokush bart armë”) të pasuar nga shqiptarët e Kosovës me 28.4% dhe pakicat e tjera me 22.6%. 32.2% e të anketuarve ishin nga zonat rurale, ndërsa 25.7% ishin nga zonat urbane. Të anketuarit nga rajoni i Prishtinës kishin më shumë të ngjarë të siguronin armë po të mundnin, me 34.1% e të anketuarve që jepnin një përgjigje të tillë. Për dallim nga kjo, vetëm 16.2% e të anketuarve nga Gjilani do të siguronin armë po të mundnin. Po ashtu, kishte një mospërputhje të madhe ndërmjet të anketuarve meshkuj dhe femra: 35.6% e të anketuarve meshkujt, kundrejt 22.1% të atyre femra thanë se do të siguronin armë po të mundnin.

8 Armët e vogla dhe siguria njerëzore në Kosovë: agjenda për veprim f 18-19, gjendet në: http://www.fiq-fci.org/images/publications/small_arms_and_security_in_kosovo_an_agenda_for_action.pdf

Armët në jetën e përditshme: rrëfimi i një gruaje


Nuk jam e sigurt se a ka qenë ShPK-ja në detyrë atë natë apo jo. Kjo ngjarje ka ndodhur në një klub të natës ku ishin të pranishëm një numër i madh njerëzish. Një djalosh i tha diçka një vajze, dhe pastaj ajo u kthye dhe e goditi atë para të gjithë të pranishmëve. Rreth dhjetë njerëz u përpoqën që ta qetësonin situatën, por ajo kërcëu dhe iu iku. Në fund, kur ajo e pa se nuk mund të përleshë fizikisht me djaloshin, e nxori armën e saj. Edhe ai e nxori armën e vet. Mandej njerëzit filluan t'i nxjerrin armët e tyre! Kjo po ndodhte në një bar ku ishin të pranishëm rreth 300 njerëz. Rojet e sigurimit të barit erdhën dhe e qetësuan situatën.

Një femër 23- vjeçare nga pjesa veriore e Mitrovicës

Prej atyre që do të siguronin një armë po të mundnin, 78.3% thanë se arsyeja kryesore për një gjë të tillë do të ishte të mbronin veten dhe familjet e tyre (shih Figurën 4 për të parë dallimet ndërmjet arsyeve të dhëna nga të anketuarit meshkuj dhe femra). Kjo po ashtu është një rritje e lehtë në mars 2006, kur 76.8% e të anketuarve do të siguronin armë për të mbrojtur familjet e tyre (dhe në qershor 2007, ku shifra ishte 69.4%). Njëra nga arsyet e tjera kryesore për sigurimin e armës ndërlidhet edhe me mbrojtjen personale: "për të mbrojtur biznesin/pronën time", arsye që u dha nga 21.1% e njerëzve në prill/maj 2008 (12.1%

në qershor 2007; 39.4% në dhjetor 2006 dhe 21.5% në mars 2006). Është interesante, numri i njerëzve që kanë dhënë arsyen, "për ta mbrojtur komunitetin tim" ka rënë në mënyrë dramatike nga 21.5% në mars 2006 në 6.9% gjashtë muaj më vonë, dhe përsëri në 3.8% dhe 3.7% në qershor 2007 dhe prill/maj 2008, përkatësisht. Ngjashëm, gjersa 24.6% e të anketuarve që do të siguronin një armë zjarri në mars 2006 do ta bënin këtë për shkak të "frikës nga konflikti/luftërat", kjo ka rënë së pari në 19.3% në dhjetor 2006 dhe pastaj 4.3% në prill/maj 2008.

■ **Figura 4:** Arsyet kryesore për sigurimin e një arme, e atyre të cilët do ta bënin një gjë të tillë (të dhëna referente: 350; përgjigjet e shumëfishta të mundshme)



Në përgjithësi, 30.6% e të anketuarve mendojnë se “deri diku ka të ngjarë” që do të ketë konflikt të dhunshëm në Kosovë në pesë vitet e ardhshme. Megjithëse kjo shifër është paksa më e lartë se në qershor 2007, numri i të anketuarve që mendojnë se një konflikt i dhunshëm “ka shumë të ngjarë” ka rënë nga 19.0% në 12.1%. Serbët e Kosovës janë më të brengosurit: 31.8% mendojnë se konflikti “ka shumë të ngjarë” dhe më tej nja 33.8% mendojnë se “deri diku ka të ngjarë”. Mirëpo, edhe kjo është më e ulët se në qershor 2007, kur 39.4% e të anketuarve serbë të Kosovës mendonin se “ka shumë të ngjarë” dhe më tej 39.4% “deri diku ka të ngjarë”.

Shkaqet kryesore për konflikt që janë përmendur në prill/maj 2008 janë “konfliktet me Serbinë” (24.2% e të anketuarve), “ndarja e Kosovës” (22.4%), “çështjet ekonomike” (8.3%), dhe “çështjet politike” (3.3%). Kjo dallon nga qershori 2007, ku 43.3% e të anketuarve dhanë si shkak të konfliktit “moszgjidhjen ose vonimin e statusit”.

A i bëjnë armët njerëzit të ndihen më të sigurt?

Pavarësisht nga fakti se një pjesë e konsiderueshme e popullatës beson se do të ketë edhe një konflikt tjetër në Kosovë, për shumë të anketuar posedimi i armëve nuk do t'i bënte individët ose anëtarët e familjeve të tyre më të sigurt. Gjithsej 60.8%, ose 64.8% të shqiptarëve të Kosovës, 40.9% të serbëve të Kosovës, dhe 64.5% të pakicave të tjera, kanë thënë se posedimi i një armë nuk do t'i bënte ata ose familjet e tyre që të ndihen më të sigurt. Kjo shifër është pak më e ulët se 63.4% në qershor të vitit 2007, por dukshëm më e lartë se 48.7% e të anketuarve të cilët kanë thënë se armët nuk do t'i bënin ata të ndihen më të sigurt në dhjetor 2006.

Numri më i vogël i serbëve të Kosovës që thonë se posedimi i armëve nuk do të bënte ata të ndiheshin më të sigurt duhet të hulumtohet. Është e vërtetë se për dallim nga grupet e tjera etnike, paksa më shumë serbë të Kosovës thonë se posedimi i armëve do t'i bënte ata të ndiheshin më të sigurt (42.9%) krahasuar me jo (40.9%). Mirëpo, në prill/maj 2008, vetëm 10.6% kanë thënë se “nuk do të


ndryshonte asgjë”. Për dallim nga kjo, në dhjetor 2006, 20.3% kanë thënë se posedimi i një arme i bën ata të ndihen më të sigurt, 13.4% kanë thënë se nuk i bën, dhe një shumicë e madhe, 43.6%, kanë thënë se nuk do të ndryshonte asgjë. Në të njëjtën kohë, në vitin 2006, vetëm 4.5% e të anketuarve serbë të Kosovës mendonin se lagjja e tyre ishte e sigurt ose shumë e sigurt. Kjo është rritur në mënyrë dramatike në 66.7% në prill/maj 2008 (55.1% në qershor 2007). Prandaj, ndjenja se posedimi i armëve mund të përmirësojë sigurinë në të vërtetë do të ishte një tregues i ndjenjave për sigurinë e përmirësuar në këtë rast: serbët e Kosovës janë ndjerë aq të pasigurt në vitin 2006, sa që nuk kishte asgjë sipas mendimit të tyre që ata do të mund të bënin për ta përmirësuar situatën; në vitin 2008, kjo mund të ndryshojë gradualisht.

Të anketuarit, shumica e të cilëve mendojnë se posedimi i armëve të zjarrit do të bënte që ata të ndihen më të sigurt ishin nga rajoni i Mitrovicës (36.0%), ndërsa ata nga rajoni i Ferizajt ishin më së paku të prirë të besojnë se pronësia ndaj armëve do ta përmirësonte sigurinë (20.7%). Personat e moshës 18-29 vjeçare po ashtu ishin të prirë që ta ndërlidhnin sigurinë me posedim të armëve, me 38.8% e të anketuarve në këtë grupmoshë që e besonin këtë gjë. Për dallim nga kjo, praktikisht nuk kishte dallime fare ndërmjet mendimeve të meshkujve dhe të femrave mbi këtë temë.

Prej atyre të anketuarve të cilët mendonin se lagjja e tyre ishte “shumë e sigurt” ose “deri diku e sigurt”, 62.5% mendojnë se posedimi i armëve nuk do t'i bënte ata të ndiheshin më të sigurt, ndërsa 41.5% nuk do të siguronin armë edhe po të mundnin kundrejt 15.2% të cilët do ta bënin një gjë të tillë. Kjo është dukshëm më e ulët se mesatarja prej 29.2% e të gjithë të anketuarve të cilët do ta siguronin nga një armë zjarri po të mundnin, dhe sugjeron që bërja e njerëzve që të ndihen të sigurt lagjet e tyre është hapi i parë kryesor për të zvogëluar përhapjen e armëve në të ardhmen.

Figura 5 e ilustron marrëdhënien ndërmjet asaj se sa i sigurt ndihet dikush dhe sa ka të ngjarë që të mendojnë se posedimi i një arme do t'i bënte ata të ndihen më të sigurt. Gjerësisht, sa

■ **Figura 5:** Lidhja reciproke ndërmjet posedimit të armës dhe ndjenjës së sigurisë
(Pyetje: A mendoni se posedimi i armëve të zjarrit bën ose do të bënte që familja juaj të ndihet më e sigurt?)



më i sigurt që të ndihet dikush, aq më pak ka të ngjarë që të mendojë se posedimi i një arme do të përmirësonte sigurinë e tyre.

Megjithatë, lidhja reciproke ndërmjet ndjenjës për siguri dhe posedimit të armës nuk është e drejtpërdrejtë. Marrëdhënia ngec te ata njerëz që ndihen “shumë të pasigurt”. Kjo ka të ngjarë për arsye se në këtë nivel të pasigurisë ekstreme, ndjenja e pafuqisë është e tillë që të anketuarit mendojnë se ata nuk mund të bëjnë asgjë (ose se mund të bëhet) që ata të ndihen më të sigurt. Lidhja reciproke ndërmjet asaj sesa të sigurt ndihen njerëzit dhe numrit të të shtënave që ata kanë dëgjuar ndjek një model të ngjashëm: sa më pak të shtëna që dëgjojnë të anketuarit, aq më

shumë ka të ngjarë që ai/ajo të ndihet i/e sigurt, përveç kur ai/ajo ndihet “shumë i/e pasigurt”, kur numri i të shtënave të dëgjuara ka fare pak rëndësi. Kjo sugjeron që zvogëlimi i përhapjes së armëve nuk mund të përmirësojë automatikisht ndjenjat për siguri ose anasjelltas. Një pjesëmarrës i grupit të fokusit nga Peja e tha këtë në mënyrë më negative: “Nuk ka siguri madje edhe kur personi bart armë. Për shembull, një person në stacionin e autobusit po barte armë, por dikush papritur shtiu në të. Pra nuk ka siguri as kur bart, e as kur nuk bart armë.”

Si mund të grumbullohen ose të kontrollohen armët?

Nismat për grumbullimin e armëve në Kosovë deri sot kanë patur pak sukses. Është qenësore që çfarëdo përpjekje për të kontrolluar ose zvogëluar numrin e armëve në posedim civil të bazohet në hulumtime të realizuara me ndjeshmëri, analiza të shëndosha të perceptimeve lokale, dhe të dizajnuara për nevojat specifike të grupeve dhe të zonave të ndryshme gjeografike.

Njerëzit ende nuk ndjehen rehat me pyetjet që ndërlidhen me armët e vogla, krahasuar me fushat e tjera. Sipas intervistuesve për këtë hulumtim, 36.0% e të anketuarve nuk janë ndjerë rehat me pyetjet që ndërlidhen me armët e vogla, më e larta për cilëndo fushë (për shembull, 27.5% nuk janë ndjerë rehat me pyetjet që ndërlidhen me krimin). Niveli i pakëndshmërisë zvogëlohej me nivelin e arsimit të të anketuarve, ata të rajonit të Prizrenit ndiheshin më rehat, ndërsa ata të rajonit të Prishtinës ndiheshin më së paku rehat. Megjithatë, kjo shifër prej 36.0% është më e ulët sesa shifra e krahasueshme e qershorit 2007 (39.3%), që mbështeste sugjerimin se njerëzit po bëhen paksa më të hapur sa i përket diskutimit të çështjeve të ndjeshme.

Kur janë pyetur sa i përket amnistisë për armë, pjesëmarrësit e grupeve të fokusit në përgjithësi kanë besuar se ato duhet të organizohen nga Qeveria me ndihmën e Policisë së Kosovës. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit në pjesën jugore të Mitrovicës njëzëri besojnë se armët duhet t'u dorëzohen autoriteteve, por përgjegjësia për këtë bie mbi "qytetarët". Ngjashëm, pjesëmarrëset femra në një grup të fokusit në Ferizaj mendonin se armët duhet të dorëzohen me një "nismë të qeverisë, me ndihmën e policisë," dhe se "njerëzit të cilët nuk kanë leje për të bartur armë duhet t'i dorëzojnë të gjitha armët e tyre", ndjenjat e tilla u përsëritën në një grup fokusit të përzier në Kamenicë. Mendimi në një grup fokusit të meshkujve në Pejë ishte më i ndarë se a duhet të dorëzohen armët, ndërkaq dy pjesëmarrës sugjeruan që armët duhet të dorëzohen "nëse

ato barten pa leje". Këtu, fokusi më shumë ishte në rolin e komunitetit dhe të familjes në grumbullimin e armëve: gjersa një pjesëmarrës sugjeroi që PK-ja duhet të jetë përgjegjëse për grumbullimin e armëve, dy të tjerë nuk u pajtuan duke thënë se "komuniteti, të afërmit dhe familja" do të duhej të ishin përgjegjës.

Për dallim nga kjo, ata në grupin e fokusit në pjesën veriore të Mitrovicës, nuk ishin të sigurt sa i përket dorëzimit të armëve, një pjesëmarrës sugjeronte se "duhet të ketë një politikë për ndalimin e bartjes së armës, e jo të posedimit të armës. Ta mbajmë armën në shtëpi, por nuk duhet të lejoheni ta bartni me vete". Një pjesëmarrës tjetër i grupit të fokusit nga Çagllavica e ndërlidhte mungesën e besimit në ofruesit e sigurisë dhe në autoritete me arsyen e vështirësive në grumbullimin e armëve: "Shumica e serbëve nuk do t'i dorëzonin armët e tyre edhe po t'i kishin. Autoritetet e Kosovës nuk ofrojnë kurrfarë sigurie çfarëdo qoftë ajo". Një pjesëmarrës nga Kamenica kishte bërë një ndërlidhje të ngjashme, këtë herë me posedimin e armëve: "Ekzistojnë disa momente që nëse nuk je në gjendje t'i ndihmosh vetes, do të kalosh shumë kohë duke pritur për ndihmë. Çdo vend i civilizuar në botë ka shembuj (ka armë) për këto raste".

Në këtë hulumtim janë dhënë edhe pyetjet nëpër tabela të ndërlidhura ndërmjet pyetjeve nga aspekti shoqëror lokal me pyetjet që kanë të bëjnë me përhapjen e armëve në pronësi, duke prodhuar disa rezultate interesante. Të anketuarit të cilët "pinin kafe me njëri-tjetrin", "bisedonin për problemet e lagjes" ose "bisedonin për çështje personale" së paku një herë në javë, ka më shumë të ngjarë që të shprehen "asnjë familje nuk ka armë" (15.0%, 17.7% dhe 17.3% përkatësisht), ndërsa ata me më pak ndërveprim të ngushtë shoqëror ("i thonë tungjatjeta njëri-tjetrit") së paku një herë në javë janë më afër mesatares prej 10.7%, në 11.6%.

Për më shumë, të anketuarit (në hulumtim) të cilët përfshihen në ndërveprimet më të ngushta shoqërore, "pinë nga një çaj" me fqinjët së paku një herë në javë, kanë më shumë të ngjarë të përgjigjen me "nuk e di" ose të refuzojnë të përgjigjen sesa familje në fqinjësi kanë armë.

68.5% e të anketuarve të cilët përfshihen në këtë lloj të ndërveprimit shoqëror nuk do të përgjigjen ose nuk e dinë se sa familje kanë armë, kundrejt një mesatare prej 61.9%, dhe vetëm 16.5% e atyre theksojnë se familjet kanë armë në komunitetin e tyre kundrejt një mesatare prej 27.4%. Në thelb, sa më mirë që e njohin njëri-tjetrin, aq më pak ka të ngjarë që ata të jenë të përgatitur që të diskutojnë punët e fqinjëve të tyre dhe ka më pak të ngjarë që të pranojnë se ka armë në lagjen e tyre.

Këto gjetje kanë implikime për çdo nismë për kontrollin e armëve. Veçanërisht në komunitet më të lidhura (afërta) mes veti, një qasje e kujdesshme për një komunitet të caktuar si dhe konsultime me komunitetin e gjerë do të jetë e nevojshme, duke u përfshirë në ndërtimin e besimit për një afat të gjatë para se të bëhet përpjekje për grumbullimin ose regjistrimin e armëve.

Përmblyje dhe rekomandime

Posedimi i paligjshëm dhe keqpërdorimi i AVL-ve paraqesin sfida për stabilitetin e Kosovës, por ka edhe indikacione pozitive të ndryshimit të perceptimeve. Së bashku, këto gjetje sugjerojnë ose që përhapja e armëve në Kosovë po rritet (njerëzit dëgjojnë më shumë të shtëna, dhe kanë perceptim se ka më shumë armë në lagjet e tyre) ose se njerëzve gjithnjë e më pak u pengon që të diskutojnë për këtë temë të ndjeshme (ku gjithnjë e më pak të anketuar refuzojnë të përgjigjen në pyetjet që kanë të bëjnë me AVL-të). Pasi që nuk ka patur asnjë sjellje të madhe të armëve në Kosovë gjatë periudhës së përcjellë, është e mundur që ndjenja gjithnjë e më rritet e sigurisë dhe mbulimi më i mirë medial, dalëngadalë po i inkurajojnë njerëzit të flasim më hapur për armët në Kosovë. Kjo duhet të shihet si zhvillim pozitiv, ndërsa diskutimi dhe debati i mëtejshëm publik duhet të inkurajohet.

Mirëpo, për shkak të ndjeshmërisë që e rrethon posedimin dhe përhapjen e armëve, mënyra e

trajtimit të kësaj çështjeje duhet të hulumtohet në mënyrë të kujdesshme dhe çdo nismë për të kontrolluar ose grumbulluar armët duhet të ideohen në atë mënyrë që t'u përshtatet nevojave specifike të komunitetit për t'i rritur maksimalisht mundësitë për paqe dhe për t'i minimizuar shkaktarët potencial të konfliktit. Komunikimi, ndërtimi i besimit dhe mbi të gjitha transparenca janë parime qenësore për zhvillimin e një regjimi të përshtatshëm vendor të kontrollit të armëve⁹.

Çdo regjim për kontrollin e posedimit të armëve nga ana e civilëve do të duhej të:

- Jetë i përshtatshëm në aspektin vendor. Çdo kulturë ka qasje të ndryshme përkitazi me pronësinë ndaj armëve. Këto qëndrime kulturore/sociale të rrënjësura thellë, po ashtu ka të ngjarë të jenë ndikuar nga faktorë më të tanishëm, menjëhershëm, siç janë ata që janë nënvizuar në këtë raport e që kanë të bëjnë me ndjenjën e perceptuar të sigurisë. Si të tilla, historia specifike e Kosovës, ndjeshmëria dhe qëndrimet ndaj armëve, si dhe konteksti i tanishëm, duhet të merren parasysh në fazën e ideimit për të siguruar sukses afatgjatë dhe qëndrueshmëri. Kjo po ashtu mund të kërkojë fleksibilitet me kalimin e kohës pasi që konteksti i tanishëm ndryshon dhe qëndrimet e mbajtura për një kohë të gjatë evoluojnë.
- Jetë ideuar duke marr parasysh kufizimet në burime dhe me një plan të detajuar për implementimin e ndryshimeve në legjisllacion. Madje edhe një kornizë legjisllative dhe struktura institucionale që janë në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare do të ishin të suksesshme vetëm nëse ato përcillen me trajnim dhe financim adekuat. Duke siguruar që ata që janë të ngarkuar

⁹ Shih Armët e vogla dhe sigurinë njerëzore në Kosovë: Agjenda për veprim (punimi i cituar.) për rekomandime më të hollësishme sesi të zhvillohet infrastruktura e Kosovës për kontroll të AVL-ve.

me implementimin e legjislacionit, posaçërisht policia dhe gjyqësori, ta kuptojnë dhe të mund ta përdorin këtë legjislacion relativisht me lehtësi kjo do të jetë shumë me rëndësi.

- T'i komunikohet publikut me kujdes. Meqë Kosova po i zhvillon institucionet dhe kornizën e vet legjislative, popullata ka nevojë që të jetë plotësisht e informuar për bazën e re ligjore të regjimit të kontrollit të armëve dhe për kërkesat e qytetarëve të veçantë. Për ta bërë këtë, institucionet përkatëse të Kosovës duhet të hartojnë një fushatë afatgjate komunikimi, duke përdorur një llojllojshmëri të metodave dhe të mediave në mbarë vendin.
- Të integrohen ose të jenë në harmoni me reformat e gjëra të sektorit të sigurisë. Ekzistojnë dimensione të kontrollit të AVL-ve në disa lëmi të ndryshme të ndërlidhura me sigurinë. Posedimi i armëve nga ofruesit e sigurisë siç janë Policia e Kosovës dhe Forca e ardhshme e Sigurisë së Kosovës do të ketë nevojë të lidhet me regjimet më të gjëra të kontrollit të AVL-ve. Hartimi i legjislacionit të ri për rolin e ofruesve privatë të sigurisë do të ketë edhe implikime në posedimin civil të AVL-ve, siç do të jetë edhe shpërbërja e pritshme e Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Strategjitë e parandalimit dhe të zvogëlimit të krimit, duke përfshirë të rinjtë dhe krimin e organizuar, po ashtu do të kenë shtrirje për një kontroll më të gjerë të AVL-ve. Zhvillimi përkatës legjislativ, institucional dhe hartimi i strategjisë duhet të jenë koherent nëpër të gjitha këto fusha. Më tej, siç e vënë në pah edhe gjetjet nga anketa, aftësia e ofruesëve të sigurisë për të siguruar dhe mundësuar një mjedis të sigurt

mund të jenë me rëndësi vendimtare për zvogëlimin e kërkesës për armë.

- Zhvillohen në mënyrë transparente. Ndjeshmëria rreth përhapjes dhe posedimit të armëve janë rënduar vetëm për shkak të mungesës së transparencës rreth zhvillimit të regjimeve të kontrollit të armëve. Të qenit i hapur është parim kryesor për të gjitha hartimet e politikave në Kosovë, ndërsa diskutimi publik është një mënyrë e rëndësishme për të pakësuar ndjeshmërinë në afat të gjatë. Për më tepër, mendimet, perceptimet dhe përvojat e publikut janë bazamenti i domosdoshëm për hartimin e një politike adekuate dhe efikase.

Çdo nismë për grumbullimin e armëve duhet të:

- Jetë në pronësi të institucioneve dhe të popullit të Kosovës. Që çfarëdo nisme për grumbullimin e armëve të jetë efektive dhe e qëndrueshme, ajo duhet të ideohet nga institucionet e Kosovës me kontribut nga publiku, dhe jo e imponuar nga jashtë.
- Ideohet në përputhje me nevojat specifike të komuniteteve të ndryshme. Dallimet në qasjen ndaj armëve dhe përhapjes së tyre në rajonet e ndryshme dhe mes grupeve të ndryshme etnike dhe grup-moshave të ndryshme do të kërkojnë përgjigje që u përshtaten të lartpërmendurve. Njerëzit gjithnjë e më shumë posedojnë armë për sigurinë e tyre sesa për të mbrojtur komunitetin e tyre, gjë që në fund të fundit do të mundësojë që grumbullimi i armëve në nivel të komunitetit të ketë sukses.

- Paraprihet me ndërtimin e besimit ndërmjet institucioneve dhe të komuniteteve. Duket se ka një marrëdhënie reciproke ndërmjet asaj sesisë mirë e njohin njerëzit njëri-tjetrin dhe sa rehatshëm e pranojnë ekzistencën e armëve në lagjet e tyre. Më tej, mosbesimi ndaj institucioneve ndërkombëtare dhe vendore nxit posedimin e armëve. Deri sa të ndërtohet besimi mes institucioneve dhe komuniteteve, nismat për grumbullimin e armëve në rastin më të mirë ka të ngjarë të jenë të paplota.
- Jetë i ndjeshëm ndaj brengave të vërteta të komuniteteve. Megjithëse lidhja ndërmjet ndjenjave për siguri dhe përhapjes së armëve nuk është e thjeshtë, në komunitetet ku pasiguria është e skajshme, grumbullimi i pamenduar mirë ka të ngjarë të rrisë pasigurinë. Analizat në nivel të komunitetit të shkaktarëve të konfliktit dhe të pasigurisë mund të jetë një mënyrë për të ideuar programet e grumbullimit të armëve, të cilat janë si përgjigje ndaj brengave specifike të komuniteteve¹⁰. Është e mundur që për të qenë të suksesshme nismat për grumbullim të armëve duhet të ideohen dhe realizohen në nivel të komunitetit (në vend se në mbarë Kosovën ose në baza individuale).
- Të përkojë në mënyrë adekuate me nismat e tjera për AVL-të, reformën e sektorit të sigurisë (RSS), nismat për ndërtimin e paqes dhe ato zhvillimore. Suksesi, ose ndryshe, i programeve të grumbullimit të armëve shpesh bazohet në krijimin e mjedisit në të cilin ata që posedojnë armë ndjehen rehatshëm në dorëzimin e armëve të tyre. Një gamë e gjerë masash nga ndërtimi i besimit

ndërmjet pjesëtarëve të komunitetit, dhe ndërmjet komunitetit dhe shërbimeve të sigurisë, e deri te ngritja në shkallë më të lartë e punës së policisë në luftimin e krimit, ose ofrimi i shërbimeve më të mira, mund të ketë nevojë që të vihen në jetë para dhe pas programeve të grumbullimit të armëve për të siguruar sukses afatgjatë. Programet e grumbullimit të armëve rrallëherë janë të suksesshme si ndërhyrje të veçuara, apo që ndërmerren vetëm njëherë.

- Të ideohen me tregues adekuatë të ndikimit. Treguesit e tillë duhet të jenë si afatshkurtër, ashtu edhe afatgjatë, dhe të fokusuar në masa të sofistikuara që kanë të bëjnë me sigurinë e individëve dhe të komuniteteve, jo thjesht në numrin e armëve të grumbulluara. Është me rëndësi që donatorët e programeve të grumbullimit të armëve ta vlerësojnë këtë nevojë për tregues të sofistikuara në fazat e ideimit të projektit.

Çdo regjim për kontrollimin e transfereve ndërkombëtare të armëve të vogla dhe të lehta duhet të:

- BJetë i bazuar në kriteret. Çdo transfer i veçantë i armëve duhet të vlerësohet për çdo rast veç e veç kundrejt kriterëve të paracaktuara. Kodi i Sjelljes i BE-së për Eksportin e Armëve rendit tetë kriteret për një transfer të armëve, duke përfshirë rrezikun nga devijimi i armëve të një pranues aksidental (kriteri i shtatë), gjasa që armët të përdoren për të kryer abuzime të drejtave të njeriut (kriteri i dytë) dhe efekti në zhvillimin e

¹⁰ Shih Kosova në udhëkryq: Perceptimet e konfliktit, qasja në drejtësi dhe mundësitë për paqe në Kosovë, Saferworld dhe FIQ (2007), për shembull një lloj analize e cila mund t'i identifikojë shtysat e konfliktit dhe sugjerojë mënyrat për zbutjes së atij konflikti përmes dizajnit të programit.

qëndrueshëm të vendit pranues (kriteri i tetë). Nëse i bashkohet BE-së, Kosovës do t'i kërkohej të nënshkruajë Kodin e Sjelljes të BE-së.

- Jetë i bazuar në verifikim rigoroz të atyre që janë të licencuar për të kryer transfere ndërkombëtare të AVL-ve (për shembull, tregtarët e armëve, ndërmjetësit, transportuesit ajror).

- Jetë transparent. Raportet publike duhet të përgatiten rregullisht dhe të jenë të hapura për shqyrtim nga ana e publikut, të përmbajnë informata të mjaftueshme për të mundësuar mbikëqyrje efikase të vendimeve të veçanta të licencimit. Po ashtu duhet të jepen informata edhe sa i përket politikës së gjithmbarshme qeveritare në këtë fushë.

Shtojca: Metodologjia

Ky studim është i bazuar në të dhënat e mbledhura gjatë muajve prill-maj 2008. Për shkak të shqetësimeve të sigurisë, shumica e intervistave janë realizuar në prill 2008, por intervistat me të anketuarit serbë të Kosovës u zhvilluan në maj 2008. Pyetësi i plotë dhe të dhënat e papërpunuara mund të gjenden në www.safeplaceproject.org. Secila nga këto hulumtime periodike përbëhet prej hulumtimit të opinionit publik (kuantitativ) si dhe një sërë fokus grupesh.

Anketa u zhvillua në mbarë Kosovën në prill-maj 2008 ku një mostër përfaqësuese prej 1,200 të anketuar ishte përzgjedhur për të mbledhur të dhëna. Margjina standarde e gabimit është 2.89 përqind me një nivel besimi prej 95 përqind. Të dhënat për këtë studim janë grumbulluar kryesisht nga intervistat me kryefamiljarët dhe sipas nevojës, me gratë (pavarësisht pozitës së tyre në një familje). Për arsye se pjesa më e madhe e kryefamiljarëve në Kosovë janë burra, me qëllim të sigurimit të një baraspeshe gjinore, gratë janë intervistuar në çdo të dytën dhe çdo të katërtën familje. Gjithsej, 52.5 përqind e të anketuarve ishin meshkuj, ndërsa 47.5 përqind kanë qenë femra. Të gjithë mbi moshën 18 vjeçare.

Gjashtë grupe fokusi lidhur me ofrimin e sigurisë në Kosovë janë përdorur për t'i vërtetuar të dhënat nga anketa e familjeve dhe për t'i hetuar më thellë çështjet e ndjeshme që ndërlidhen me ofrimin e sigurisë. Këto grupe fokusi kanë qenë, si vijon: Ferizaj, Kamenicë, Pejë, Çagllavicë, pjesa jugore dhe veriore e Mitrovicës. Pjesëmarrësit ishin meshkuj dhe femra të moshës 18-30 vjeçare.

Ky studim përmban edhe të dhëna nga anketat që kanë ndjekur metodologji të ngjashme në mars 2006¹¹, dhjetor 2006¹² dhe qershor 2007.

11 Anketa për Armët e Vogla dhe të Lehta në Kosovë, punimi i cituar.

12 Siguria njerëzore në Kosovë: Anketa e perceptimeve, punimi i cituar.

Projekti Vend i Sigurtë është program pune
i përbashkët i organizatave joqeveritare
Saferworld dhe FIQ që mbështetë sektorin e
sigurisë në Kosovë për një zhvillim të efektshëm,
llogaridhënës dhe të ndjeshëm ndaj konfliktit.

www.safeplaceproject.org

Saferworld

The Grayston Centre, 28 Charles Square
London N1 6HT, United Kingdom
+44 (0)20-7324-4646
www.saferworld.org.uk

Forumi për Iniciativa Qytetare

Rr. Bedri Pejani, 7/A
10000 Prishtinë, Kosovë
+381 (0)38-248-677
www.fiq-fci.org